

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË VORË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Vorë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.09.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 187, datë 29.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 951/7, datë 29.12.2014, i ka rekomanduar z. Fiqiri Ismaili, Kryetar i Bashkisë Vorë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A.MASA ORGANIZATIVE.

1. Gjetje nga auditimi: - Sektori i Financës nuk ka përgatitur një dokument, ku të përshkruaj organizmin dhe procedurat kontabël, i cili është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditit.

-Bashkia Vorë nuk ka kryer investime në teknologjinë e informacionit për programe në fushën e administrimit financiar etj. për rritjen e efektivitetit të përdorimit të informacionit financiar.

-Nga auditimi i pasqyrave financiare (bilanceve kontabël) të viteve 2012-2013 konstatohet se nuk janë saktësuar në mënyrë analitike aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe aktivet qarkulluese, në mbështetje të inventarit kontabël e fizik.

-Zyra e Financës nuk ka marrë masa për informatizimin e veprimeve me magazinimin, me qëllim që të ndiqet gjurma e konsumit apo e amortizimit.

-Sektori i Financës në bashkëpunim me Sektorin Juridik, nuk kanë parashikuar detyrimet për investimet e kryera (garancinë e defekteve), në zbatim të kërkesave të UMF “Për zbatimin e buxhetit” të viteve 2012-2013.

-Bashkia Vorë nuk ka marrë masa për tu kryer inventarizimin fizik të aktiveve në pronësi (me përjashtim të inventarit ekonomik dhe aktive qarkulluese).

- Nuk është zbatuar metoda e shpenzimeve dhe e të ardhurave, e cila ka të bëjë me: njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës.

- Në disa transaksionet të kryera në periudhën objekt auditimi konstatohet likuidim me vonesë i punimeve, mallrave dhe shërbimeve.

- Nëpunësi zbatues nuk ka kontabilizuar ngurtësimin e fondeve, për cilësinë e punimeve për vitin 2012, 2013 dhe 2014 (Janar –Maj)

- Në dy raste, me objekt shpenzimi “Sigurimi i objekti” autoriteti kontraktor ka përdorur procedurën me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu IV pika 5, germa c.

-Në të gjitha transaksionet e audituara autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar nenet 2 dhe 32 të kontratës së sipërmarrjes, ku përcaktohet se pagesat për situacion punimesh, në zbatim të nenit 31, do të kryhen nga autoriteti kontraktor brenda 15 ditëve nga data e paraqitjes së situacionit nga mbikëqyrësi i punimeve tek autoriteti kontraktor.

- Në të gjitha transaksionet e audituara nuk janë amendamentet e kontratave (shtesat e kontratave) bashkëlidhur dokumenteve të likuidimeve, gjë që mungon gjurma e auditimit në lidhje me zbatimin e nenit 3 “afati i realizimit të punimeve” dhe nenin 36 “dëme, të likuidueshme për vonesa në mbarimin e punimeve”.

-Në katër raste nuk është zbatuar vendimi nr. 1173, datë 6.11.2009 Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”.

1.1 Rekomandim: Sektori i Financës i NJQV Vorë:

- Të përgatit një dokument ku të përshkruaj organizimin dhe procedurat kontabël, i cili është i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditit në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare”,

- Të saktësojë sipas analizave aktivet e qëndrueshme të trupëzuara, në mbështetje të inventarizimit kontabël dhe fizik, në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe Udhëzimit të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Të marrë masa për informatizimin në fushën e administrimit financiar për rritjen e efektivitetit të përdorimit të informacionit financiar, me qëllim që të ndiqet gjurma e konsumit apo e amortizimit të aktiveve konform VKM nr. 248, date 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njërive që varen prej tyre”, i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001.

- Të marrë masa për kontabilizimin e ngurtësimit të fondeve, për cilësinë e punimeve dhe likuidim sipas kontratës së punëve, mallrave dhe shërbimeve.

-Të zbatohet metoda e shpenzimeve dhe e të ardhurave, e cila ka të bëjë me njohjen e shpenzimeve korrente dhe kapitale të vitit buxhetor në çastin e ndodhjes së tyre, pavarësisht nga data e pagesës.

- Të marrë masa konkrete duke koordinuar punën me strukturat përkatëse, në drejtim të arkëtimit të debitorëve.

-Të parashikojnë detyrimet afatshkurta ndaj të tretëve, gjatë përgatitjes së projektbuxhetit korrent dhe projektbuxhetit afatmesëm, të cilat në fund të vitit 2013 rezultojnë në vlerën 7,512,989 lekë.

-Bashkia Vorë të përdorë vetëm për raste të veçanta procedurën “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, pasi në mungesë të konkurrencës nuk arrin të realizojë plotësisht nevojat për mallra, punë e shërbime, si dhe duhet të merren gjithashtu në konsideratë ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti në zhvillimin e procedurave të prokurimit.

-Të bashkëlidhen pagesës së shërbimit të “Mirëmbajtja e rrugëve të Bashkisë Vorë”:

a. Çertifikatën mujore të Pagesave që firmoset nga Kontraktori dhe vërtetohet nga Menaxheri i Projektit.

b. Certifikata duhet të përfshijë një sigurim nga Kontraktori që ai ka qenë në pajtim me nivelet e shërbimit dhe cilësinë e punimeve të specifikuar sipas Kontratës. PAGESA TË BAZOHET NË SASITË DHE ÇMIMET NJËSI NË PREVENTIV, duke përfshirë çfarëdo pagese në shumë fikse dhe pagese për ditë pune. Kërkesat për pagesa të shoqërohen nga dokumentacion mbështetës dhe raporti verifikues sipas seksionin A.3 “Inspektime dhe Prova”.

Vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Vorë nuk ka ekzekutuar, në mënyrë vullnetare vendimin Gjyqësor nr. 4890, datë 15.05.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimin nr. 72, datë 17.01.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë për dëmshpërblimin e z. Q.L. duke shkaktuar pagesa të tepërta në vlerën 482,101 lekë, pasi entiteti ka paguar padrejtësisht tarifën ndaj Përmbaruesit Gjyqësor.

2.1 Rekomandim: Këshilli i Bashkisë Vorë të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësinë, për shpenzimet e përmbarimit në vlerën **482,101 lekë**, pasi strukturat përkatëse nuk kanë ekzekutuar në mënyrë vullnetare vendimin Gjyqësor për dëmshpërblimin e z. Q.L.

3. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e audituar në Sektorin e Taksave dhe Tarifave vendore të Bashkisë Vorë, nga mos arkëtimi i detyrimeve deri më datë 30.09.2014 janë krijuar debitorë në

vlerën 48,171,000 lekë.

3.1 Rekomandim: Nga Sektori i Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Financës, Sektorin e Ujësjetësimit dhe Sektorët e shërbimeve të Bashkisë, të merren masa për arkëtimin e **detyrimeve** të pa likuiduara deri më datën 30.09.2014 në vlerën **48,171,000 lekë**, përkatësisht:

- për taksën e biznesit të madh nga 97 subjekte në vlerën **11,277,000 lekë**, për taksën e biznesit të vogël nga 29 subjekte në vlerën **15,267,000 lekë**,

- taksën e tokës bujqësore nga 577 familje në vlerën 4,150,000 lekë, taksën e ndërtesës nga 998 familje në vlerën 2,144,000 lekë, tarifën e ujit të pijshëm nga 733 familje në vlerën 15,333,000 lekë.

Deri me datë 30.04.2015

4. Gjetje nga auditimi: Për periudhën e audituar në Sektorin e Ujësjetësimit të Bashkisë Vorë, nga mos azhurnimi me sektorin e taksave dhe tarifave vendore të veprimeve të zbritjeve nga plani i miratuar në fillim të çdo viti i tarifave të ujit të pijshëm për shkak të ndërprerjeve të ujit të pijshëm për shkaqe të punimeve të ndërtimit, të defekteve, të mos funksionimit të linjave dhe pompave, të mungesës së energjisë elektrike, sipas dokumentacionit të administruar detyrimet nuk rakordojnë për vlerën 29,182, 000 lekë.

4.1 Rekomandim: Nga sektori i Ujësjetësimit në bashkëpunim me sektorin e Taksave e Tarifave Vendore dhe sektorin e Financës, sipas dokumentacionit të administruar të rakordohet midis tyre dhe detyrimi i pasqyruar nga sektori i taksave dhe tarifave vendore deri më datë 30.09.2014 në vlerën 29,182,000 lekë, të reflektohet në planin e të ardhurave vendore

Deri me datën 30.04.2015

5. Gjetje nga auditimi: - Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Vorë (DPKZHT) nuk ka hartuar formularin e plotësimit të dokumentacionit bashkëlidhur kërkesës për aplikim.

-Kërkuesi nuk ka paraqitur vërtetim për përmbushjen e detyrimeve tatimore, në të cilin DRT vërtetojmë se, Tatimpaguesi i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore me NIPT me aktivitet kryesor në fushën e ndërtimit, nëse rezulton i rregullt në zbatimin e legjislacionit tatimor dhe nuk ka detyrime tatimore të papaguara në buxhetin e shtetit deri në datën e lëshimit të këtij vërtetimi për objektin: Lloji i objektit, vendndodhja dhe numri i lejes, para kërkesës së subjektit për pajisje me leje përdorimi.

-DPKZHT nuk ka rillogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja e përcaktuar në VKB nr. 35, datë 16.12.2011, “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2012”, VKB nr. 43, datë 26.12.2012, “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2013”, VKB Nr. 4, datë 05.02.2014, “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2014”, pasi në procedurat e dhënies së lejeve zhvillimore/ndërtimit dhe lejeve të përdorimit vlera e preventivit të projektit të zbatimit dhe vlera e situacionit përfundimtar janë më e vogla se vlerat e rillogaritura, sipas manualit të çmime të punimeve të ndërtimit të miratuara me VKM përkatëse, ose e rillogaritur me koston mesatare të ndërtimit për vitin përkatës të përcaktuar nga EKB dhe miratuar me Udhëzim të KM .

-Në dosjen e procedurave të dhënies së lejes së përdorimit mungojnë: Proces verbalet e punimeve të maskuara dhe procesverbali i grupës së themelit dhe certifikatat e materialeve nga laboratorët e licencuar.

5.1 Rekomandim: -Të hartohet nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit pranë Bashkisë Vorë (DPKZHT) formulari në lidhje me plotësimin e dokumentacionit bashkëlidhur kërkesës për aplikim.

-Aplikuesi të paraqesë vërtetim për përmbushjen e detyrimeve tatimore, në të cilin DRT vërtetojmë se, Tatimpaguesi i regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore me NIPT me aktivitet kryesor në fushën e ndërtimit, rezulton i rregullt në zbatimin e legjislacionit tatimor dhe nuk ka detyrime tatimore të papaguara në buxhetin e shtetit, para kërkesës së subjektit për pajisje me leje përdorimi.

- Të rillogariten taksat e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja nga DPKZHT sipas Vendimeve të Këshillit të Bashkisë, për arsye se në procedurat e dhënies së lejeve zhvillimore/ndërtimit dhe lejeve të përdorimit, vlera e preventivit të projektit të zbatimit dhe vlera e situacionit përfundimtar, janë më e vogla se vlerat e rillogaritura sipas manualit të çmime të punimeve të ndërtimit të miratuara me VKM përkatëse, ose e rillogaritur me koston mesatare të ndërtimit për vitin përkatës të përcaktuar nga EKB dhe miratuar me Udhëzim të KM.
- Të merren masa për plotësimin e dosjes së procedurave të dhënies së lejes së përdorimit me procesverbalet e punimeve të maskuara dhe certifikatat e materialeve nga laboratorët e licensuar.

Vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Në raportet finale të auditit të brendshëm dhe masat e rekomanduara nga auditimet e ushtruara, megjithëse janë vlerësuar dhe kanë pasur mbështetjen e nevojshme për zbatim nga titullari i institucionit, është konstatuar se duhet punuar në drejtim të rregullshmërisë së tyre formale, argumentimin e shkeljeve dhe mbështetjen ligjore për masat dhe rekomandimet e lëna për eliminimin e të metave.

6.1 Rekomandim: Auditimi i brendshëm gjatë procesit të auditimit për të rritur efektivitetin dhe performancën e tij, duhet të vlerësojë punën në drejtim të rregullshmërisë formale të dokumentacionit, argumentimin e shkeljeve të konstatuara dhe mbështetjen ligjore për masat dhe rekomandimet e lëna për eliminimin e të metave dhe për përmirësimin e punës në të ardhmen mbi parregullsitë e konstatuara, si dhe ndjekjen në vazhdimësi të realizimit të tyre brenda afateve të përcaktuara.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi: Policia e Bashkisë Vorë funksionon me rregulloren e vet të miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 15, datë 20.02.2010, ku janë përcaktuar detyrat dhe të drejtat e të gjithë punonjësve. Ky vendim është nxjerrë në mbështetje të “Rregullores së Brëndshme “TIP” e Policisë së Bashkisë dhe Komunës”, të miratuar me urdhrin e përbashkët të dy ministrive, si Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit dhe Ministria e Rendit Publik.

Nga verifikimi i dosjeve të tyre u konstatua, se inspektori i policisë së Bashkisë Vorë dhe policët bashkiakë, ishin me arsim të mesëm që nga viti 2005, të cilët sipas nenit 4 të ligjit nr.8224, datë 15.05.1997, i ndryshuar, pika 5 e nenit 11 Kreu III i Rregullores së Brëndshme TIP, të Policisë së Bashkisë/Komunës: “Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi”.

7.1 Rekomandim: Titullari i institucionit dhe Sektori i Burimeve Njerëzore me punonjësit e Policisë së Bashkisë, të lidhin kontratën individuale të punës me afat jo më pak se tre vjeçar, sikurse përcaktohet të pikën 9, paragrafi i dytë i urdhrin të përbashkët të dy ministrive Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit nr. 1530, datë 07.04.2003, si dhe Ministria e Rendit Publik nr. 823 datë 11.04.2003 “Për miratimin e rregullores TIP”.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Në kontrollet e ushtruara nga INUV për kundravajtjet e konstatuara janë vendosur 11 (njëmbëdhjetë) gjopa në vlerën **12.420.840 lekë** të cilat nuk janë rregjistruar në kontabilitet dhe për rrjedhojë nuk është arkëtuar asnjë prej tyre, veprime këto në kundërshtim me Kreun e V, pika 4 e nenit 30 “Arkëtimi i detyrimeve” të ligjit 10279, datë 20.05.2010 “Për kundravajtjet administrative”.Mos vjelja e gjobave të mësipërme për kundravajtjet e konstatuara në vlerën **12.420.840 lekë** janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Vorë.

8.1 Rekomandim: INUV të dorëzojë në sektorin e Financës 11 (njëmbëdhjetë) gjobat e administruara në vlerën **12.420.840 lekë** për efekt kontabilizimi të detyrimit dhe të ndjekë arkëtimin e tyre.

Deri me datën 31.03.2015

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në Sektorin e shërbimit social në disa dosje të ndihmës ekonomike mungonin vërtetimi i shkollës për minorenët, gjë e cila është në kundërshtim me pikën 6 të VKM nr.787, datë 14.02.2005. Gjithashtu dosjet e ndihmës ekonomike nuk ishin të inventarizuara.

9.1 Rekomandim: Sektori i shërbimit social për dhënien e ndihmës ekonomike të kompletojë të gjitha dosjet me dokumentacionin e nevojshëm ligjor kërkesave të përcaktuara në pikën 6 të VKM nr.787, datë 14.02.2005, i ndryshuar dhe të ribëjë inventarizimin e dosjeve të ndihmës ekonomike.

Deri me datën 31.03.2015

10. Gjetje nga auditimi: Sektori i Ujësjellësit të Bashkisë Vorë, nuk ka mbajtur dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor dhe ekonomik për lëvizjet e personelit drejtues, si dhe nuk ka analizuar gjendjen ekonomiko-financiare dhe për të përmirësuar punën dhe rritur treguesit e arkëtimit të detyrimeve për tarifat e ujit të pijshëm.

10.1 Rekomandim: Titullari i Bashkisë, sektori i Burimeve Njerëzore, sektori i Financës dhe sektori i taksave dhe tatimeve vendore, të marrin masa për riorganizimin e sektorit të Ujësjellësit të Bashkisë Vorë, duke caktuar specialistë të sektorit të fushës përkatëse dhe ekonomist, me qëllim rakordimin mujor midis shpenzimeve për ujësjellësin, prodhimin e faturuar dhe detyrimet e mbetura.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga 277 pasuri në total të miratuara, nga ana e Bashkisë Vorë janë aplikuar për t'u regjistruar në ZVRPP Tiranë vetëm 102 pasuri, për të cilat janë marrë certifikatat e pronësisë për 49 pasuri prej tyre dhe mbeten për t'u pajisur me certifikatë pronësie edhe 53 pasuri.

Për 175 pasuri e tjera, të pa aplikuar për regjistrim pranë ZVRPP Tiranë, nga ana e sektorit të Pronave Publike dhe Pyjeve pranë Bashkisë Vorë të përgatitet dokumentacioni tekniko ligjor, me qëllim aplikimin për regjistrimin pranë ZVRPP-së Tiranë.

11.1 Rekomandim: Nga titullari i Bashkisë Vorë dhe sektori i Pronave, të merren të gjitha masat për vlerësimin e aseteve, regjistrimin e 175 pasurive në ZVRPP Tiranë, marrjen në dorëzim të pronave të paluajtshme publike e shtetërore, dhënien e tyre me qira dhe regjistrimin e aseteve në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabilitetin, me qëllim sigurimin e të ardhurave për Bashkinë.

Vazhdimisht

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bashkia Vorë të marrë masa, duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **3,534,108 lekë** dhe ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, konkretisht:

1. Gjetje nga auditimi: Sipas të dhënave mujore për energjinë e konsumuar në muajin Gusht 2010, CEZ ka faturuar 86 140 kËh më tepër ose në vlerën 835,558 lekë, se sa konsumi i regjistruar nga matësi i energjisë. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 32-47 të Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: **Vlera 835,558 lekë**, nga operatori ekonomik "C... Shpërndarje" sh.a, për sa faturuar më tepër se konsumi i regjistruar nga matësi i energjisë, për muajin Gusht 2010.

Deri më datën 31.01.2015

2. Gjetje nga auditimi: Autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar nenin 23 "Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit" dhe nenin 24 "Likuidimi i dëmeve për dorëzim të vonuar", të kontratës nr. 264/4, datë 27.03.2013 me objekt "Furnizim vendosje pemë dekorative dhe sistemim, gjelbërim i dy rreth rrotullimeve në hyrje të Vorës", duke shkaktuar dëm ekonomik të arkëtueshëm nga operatori ekonomik "K..I" shpk në vlerën 448,863 lekë.

2.1 Rekomandimi: **Vlera 448,863 lekë**, nga operatori ekonomik "K..I", e cila përfaqëson shumën e moszbatimit të penaliteteve për 15 ditë vonesë, në zbatimin e kontratës nr. 264/4, datë 27.03.2013 me objekt "Furnizim vendosje pemë dekorative dhe sistemim, gjelbërim i dy rrethrotullimeve në hyrje të Vorës".

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nuk është bashkëlidhur faturës gazeta e datës 05.04.2013 për 9 njoftime në vlerën **45,000 lekë**, nga operatori ekonomik "Gazeta R..D", në transaksionin nr. 138, datë

01.07.2013 për blerjen zhvillim, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizive ose botim në median e shkruar dhe për kontrata, për kohë transmetimi, nga organet e Administratës Shtetërore.

3.1 Rekomandim: Vlera 45,000 lekë, e cila përfaqëson shumën e përfituar padrejtësisht, nga operatori ekonomik “**Gazeta R..D**”, për moskryerjen e shërbimit të publikimit në media e shkruar.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi: Llogaritja e pagesës për kolaudim punimesh ndërtimi në kontratën me objekt: “Ndërtimi i rrugëve të lagjeve Dunga - Marikaj”, sipas transaksionit nr. 154, datë 08.07.2013 në vlerën 111,429 lekë, është bërë në kundërshtim me Kreun “B” “*Tarifat për kolaudimin përfundimtar të punimeve të ndërtim-montimit të përcaktuar në VKM nr. 444, datë 05.09.1994 “Për Tarifat e Studimit, Projektimit, Drejtimit dhe Kolaudimit të Veprave të Ndërtimit”, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 56,551 lekë, nga subjekti “Ballkan Engineering”.*

4.1 Rekomandim: Vlera 56,551 lekë, e cila përfaqëson shumën e përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik “**B..E...**”, pasi pagesa për kolaudim punimesh ndërtimi sipas transaksionit nr. 154, datë 08.07.2013, nuk është kryer konform dispozitës ligjore në fuqi.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në situacionin përfundimtar operatori ekonomik “**S...2...**”, në kundërshtim me nenin 7, paragrafi i tretë i ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, pasi si rezultat i situacionimit të punimeve të pa kryera për tre zëra në objektin: “Sistemim dhe asfaltim i rrugës Ambulanca e vjetër-ish Reparti Ushtarak Vorë dhe segmenti i rrugës Varrezave të qytetit Vorë të brendshme faza e dytë”, ka përfituar më tepër vlerën **119,988 lekë**.

5.1 Rekomandim: Vlera 119,988 lekë, e cila përfaqëson shumën e përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik “**S...2...**”, pasi ka përfituar më tepër në objektin: “Sistemim dhe asfaltim i rrugës Ambulanca e vjetër-ish Reparti Ushtarak Vorë dhe Segmenti i rrugës Varrezave të qytetit Vorë të brendshme, faza e dytë” .

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në situacionin përfundimtar operatori ekonomik “**H..I**”, në kundërshtim me nenin 7, paragrafi i tretë i ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” pasi si rezultat i situacionimit të punimeve të pa kryera për katër zëra në objektin: “Sistemim i rrugës rruga kryesore e fshatit Dunga-Varreza Marikaj”, ka përfituar më tepër vlerën 331,610 lekë. (*Trajtuar më hollësisht në faqen 55-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandim: Vlera 331,610 lekë, e cila përfaqëson shumën e përfituar padrejtësisht nga operatori ekonomik “**H..I**”, pasi ka situacionuar punime të pa kryera për katër zëra në objektin: “Sistemim i rrugës rruga kryesore e fshatit Dunga-Varreza Marikaj”.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Në situacionin përfundimtar bashkimi i operatorëve ekonomik “**S..A & G..C...**”, në kundërshtim me nenin 7, paragrafi i tretë i ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, pasi si rezultat i situacionimit të punimeve të pa kryera për dy zëra në objektin: “Stacioni i pompave i Ujësjellësit Vorë-Gjokaj-Picar-Dedëj dhe STP qendror Ujësjellësi Rajonal Bashkia Vorë”, ka përfituar më tepër vlerën **616,420 lekë**.

7.1 Rekomandim: Vlera 616,420 lekë, e cila përfaqëson shumën e përfituar padrejtësisht nga bashkimi i operatorëve ekonomik “**S..A & G..C...**”, pasi ka situacionuar punime të pa kryera për dy zëra në objektin: “Stacioni i pompave i Ujësjellësit Vorë-Gjokaj-Picar-Dedëj dhe STP Qendror Ujësjellësi Rajonal Bashkia Vorë”.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nisur nga ankesa e ish punonjësës M.Q. dhe nga përlllogaritja e pagesës në vlerën bruto **1,189,076 lekë** nga data 18.07.2005 deri më 31.03.2009, *data e zbatimit të vendimit gjyqësor*, nga e cila e paguar në fakt për 40 muaj në vlerën 1,071,240 lekë dhe asaj të llogaritur por të pa paguar për 4 muaj e 12 ditë (nga data 18.11.2008 deri 31.03.2009) në vlerën 117,836 lekë nuk janë aplikuar detyrimet për:

- *tatimin mbi të ardhurat personale* të ish punonjësës M.Q. në vlerën 639 lekë/muaj për 44 muaj e 12 ditë ose gjithsej në vlerën 28,372 lekë.

- *sigurimet shoqërore dhe shëndetësore*, të cilat përballohen nga vetë ish punonjësja M.Q. në vlerën 3,000 lekë/muaj për 44 muaj e 12 ditë ose gjithsej në vlerën 133,200 lekë.

Sipas përlllogaritjes deri më 31.03.2009 pagesa me pagën bruto arrin në vlerën 1,189,076 lekë por duke llogaritur dhe zbritur ndalesat për detyrimet si më sipër ndalesat në vlerën 161,572 lekë (*tatim mbi të ardhurat 28,372 lekë + sig.shoqërore 133,200 lekë*) duhej të merrte vlerë neto 1,027,504 lekë.

Nisur nga ankesa e ish punonjësës M.Q. pavarësisht nga veprimet dhe mos veprimet e administratës të Bashkisë Vorë dhe Zyrës Përmbarrimore Tiranë, duke qenë para faktit se ish punonjësja është paguar në vlerën 1,071,240 lekë në një kohë që duhej paguar në vlerën 1,027,504 lekë rezulton se *është paguar më tepër në vlerën 43,736 lekë*.

7.1 Rekomandim: Për zgjidhjen e ankesës së zj. M.Q.dhe eliminimin e të metave dhe dobësive të konstatuara dhe në zbatim të plotë të Vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë nr.398, datë 21.11.2007 dhe Vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil nr.146, datë 09.07.2007 rekomandojmë:

a. Ish punonjësja të arkëtoj për llogari të Bashkisë Vorë detyrimin në vlerën **43,736 lekë** si pagesa të tepërta të përfituara, nga pagesa e kryer mbi pagën bruto pa aplikuar tatimin mbi të ardhurat personale dhe detyrimet për sigurimet shoqërore, (*për 44 muaj dhe 12 ditë*) për periudhën 18.07.2005 deri më 31.03.2009.

b. Bashkia Vorë të derdhë pranë Drejtorisë Rajonale të Tatim Taksave Tiranë detyrimet e ish punonjësës për *tatimin mbi të ardhurat personale* në vlerën 639 lekë/muaj për 44 muaj e 12 ditë ose gjithsej në vlerën 28,372 lekë.

c. Bashkia Vorë të derdhë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë detyrimet e ish punonjësës për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të llogaritura dhe ndaluara në pagën personale (*për 44 muaj x 3000 lekë/muaj dhe 12 ditë*) për periudhën 18.07.2005 deri më 31.03.2009 në vlerën **133,200 lekë**.

d. Bashkia Vorë të derdhë pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë detyrimet e Bashkisë për kontributin e sigurimeve shoqërore e shëndetësore të ish punonjësës të llogaritura (*për 44 muaj dhe 12 ditë*) për periudhën 18.07.2005 deri më 31.03.2009 në vlerën **299,970 lekë**.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013 miratuar më datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, rekomandojmë që të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore sipas shkallës, nga “*Vërejtje*” deri në “*Largim nga detyra*”, duke i lënë në kompetencën e kryetarit të Bashkisë Vorë, për **19** punonjësit, si më poshtë:

1. z. A.D. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël, Menaxherit të Projektit “Mirëmbajtja e rrugëve të Bashkisë Vorë” dhe të anëtarit të Njësisë së prokurimit.

2. zj. A.Z. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Administratës, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël.

3. z. B.S. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Ujësjetës, Specialist në Sektorin e Pronave Publike dhe Pyjeve, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Prokurimeve me vlerë të vogël.

Për arsye se:

- Në pesë raste ka përdorur procedurën prokurim me vlerë të vogël, për shërbimet e projektimit, në kundërshtim me kreun IV 4. Konkursi i projektimit, Kreu VI, zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozime, prokurim me vlerë të vogël shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit.

-Nuk ka zhvilluar procedurë prokurimi për mbikëqyrje punimesh, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1, datë 16.6.2011 Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

-Ka copëzuar fondi në lidhje me objektin Projekt –Sistemim asfaltim i rrugës Marqinet-Qendra e mbylljes për të huajt, Karreq” me vlerë të investimit 48.191.406 leke pa tvsh, për arsye se vlera e shërbimit të projektimit është ndarë në dy objekte, sipas urdhër shpenzimi nr. 171, datë 28.06.2012, në vlerën 476,159 lekë me objekt shpenzimi “Projekti i sistemi asfaltim i rrugëve Marqinet-qendra e mbylljes për të huajt Karrec (Sakos) aksi 1” (vlera e investimit 48,191,406 leke pa tvsh) dhe USH nr. 172, datë 28.06.2012, në vlerën 478, 247 lekë me objekt shpenzimi “Projekti i sistemi asfaltim i rrugëve Marqinet-qendra e mbylljes për të huajt, Karrec (Sakos) aksi 1 pjesërisht dhe Aksi 2”, në kundërshtim me nenin 27 “Kufijtë monetar” dhe pika 5 e nenit 29 procedurat standarde të prokurimit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

-Nuk ka hartuar dokumentet e kërkuara në specifikimet teknike bashkëlidhur kontratës nr. 78/5, datë 24.05.2012, me objekt “Mirëmbajtja e rrugëve të Bashkisë Vorë, në të cilën përcaktohet se kontraktori do paguhet çdo muaj ne përputhje me Certifikatën Mujore të Pagesave që firmoset nga Kontraktori dhe vërtetohet nga Menaxheri i Projektit.

4. z. B.C. me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik, në cilësinë e kryetarit të KVO dhe në cilësinë e kryetarit të prokurimeve me vlerë të vogël.

5. zj. O.S. në cilësinë e anëtares së komisionit të prokurimeve me vlerë të vogël,

Për arsye se:

-Në katër raste nuk ka zbatuar vendimin nr. 1173, datë 6.11.2009 Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”.

6. zj. A.D. me detyrë ish Përgjegjëse e Sektorit të Financës, nga data 28.10.2013 deri 03.01.2014 në cilësinë e anëtarit të KVO.

7. z.L.B. me detyrë Drejtor i Urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të KVO.

8. z. A.D. me detyrë specialist në Drejtorinë e urbanistikës, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit.

Për arsye se:

-Specialistët e Autoritetit Kontraktor që kanë përgatitur preventivin e zbatimit, specifikimet teknike, vlerësimin dhe përlllogaritjen e fondit limit, vlerën e kontratës janë anëtar të Njesisë së Prokurimit.

- Njësia e Prokurimit dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave janë ngritur së bashku (jo me urdhër të veçantë), veprim në kundërshtim me pikën 5 të nenit 12 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika 1/b dhe pika 4/d e VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar

- Njësia e Prokurimit në procesverbalin mbi përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, justifikimin e fondit limit dhe specifikimeve teknike, të realizuara nga komisioni i ngritur për këtë qëllim, në kërkesën për propozim nuk ka dërguar ftesën të paktën pesë operatorëve ekonomik për marrjen e propozimeve, veprim në kundërshtim me Kreu VI “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për

propozime” pika 1/b e VKM nr.1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar.

- Nga ana e KVO nuk është mbajtur procesverbal i vlerësimit dhe kualifikimit të ofertave të paraqitura nga pjesmarrësit për vlerësimin e gjithë dokumentacionit të tyre, sipas sipas VKM nr.1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar kreu V, pika 4, germa “g”.

10. zj. A.S. me detyrë specialiste e Sektorit të Ujësjellësit,

Për arsye se:

-Nuk është rakorduar periodikisht me sektorin e taksave dhe sektorin e financës për debitorët për tarifën e ujit të pijshëm nga ku nga viti 2011 deri më 30.09.2014 rezulton një diferencë midis tyre në vlerën 29,182 mijë lekë.

-Nuk janë arkëtuar detyrimet e tarifës së ujit të pijshëm për vitin 2011 deri më 30.09.2014 nga 733 familje në vlerën 15,333 mijë lekë.

11. z. R.A. me detyrë përgjegjës i Policisë Bashkiake.

Për arsye se:

Për periudhën tre vjeçare nuk janë kryer trajnime dhe kualifikime të punonjësve të Policisë Bashkiake

Nuk janë dokumentuar në sektorin e financës gjobat e vendosura nga Policia Bashkiake duke mbetur pa arkëtuar vlera 21,500 lekë.

12. z. L.P. me detyrë përgjegjës i sektorit të ndihmës ekonomike.

Për arsye se:

Nuk janë bërë vizita në familjet përfituese të ndihmës ekonomike dy herë në vit sipas pikës 11 të Udhëzimit nr.338/3, datë 10.03.2006 “Mbi zbatimin e VKM nr.787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të përfituesve dhe të masës së ndihmës ekonomike”

Në disa dosje të përfituesve mungonin vërtetimet e shkollës për minorenët.

Dosjet e ndihmës ekonomike nuk janë të inventarizuara.

13. z. P.S. me detyrë përgjegjës i INUV.

Për arsye se:

Nuk janë dokumentuar në sektorin e financës gjobat e vendosura nga INUV duke mbetur pa arkëtuar 11 gjoba në vlerën 12,420,840 lekë.

14. z. A.S. me detyrë përgjegjës i Sektorit të taksave dhe tarifave vendore.

15. zj. A.H. me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore.

16. zj. G.A. me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore.

17. zj. E.K. me detyrë specialiste e taksave dhe tarifave vendore.

18. z. A.M. me detyrë specialist i taksave dhe tarifave vendore.

19. z. K.D. me detyrë specialist i taksave dhe tarifave vendore.

Për arsye se:

Nuk janë parashikuar dhe realizuar si duhet taksat dhe tarifave vendore dhe megjithatë kanë mbetur pa arkëtuar për vitin 2012 vlera 42,972 mijë lekë dhe për 9 mujorin e vitit 2014 vlera 6,723 mijë lekë.

Evidencat periodike të realizimit të taksave dhe tarifave vendore nuk pasqyrojnë realitetin pasi në to përfshihen të ardhura të realizuara por të pa planifikuara, arkëtimi i detyrimeve të viteve të mëparshme paraqitur si realizim i vitit ushtrimor, etj.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 01.06.2000, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e Rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së Liçencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, ndryshuar me VKM nr. 92, datë 19.02.2014, Kreu VII, “Sanksione”, pika 1, shkronja (a), Pika I-Konstatohen ose provohen deklarime, të rreme, **i rekomandojmë** Komisionit të dhënies së Liçencave, pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, **që për shkelje të ligjshmërisë në ndërtim të vendosë sanksionet dhe masa administrative në varësi të shkallës së përgjegjësisë, për subjektet:**

1. “R...S...”, e licencuar (licenca me nr. MK 1996/3, datë 15.10.2012), me të cilën është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 173, datë 02.11.2012, për shkak se:

a- Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit si dhe nuk janë pasqyruar në librin e masave me referencë projektin e zbatimit.

b- Si rezultat i situacionimit më tepër volume punimesh në katër zëra punimesh të pa kryera, në objektin “*Sistemi i rrugës kryesore të fshatit Dungas- Varreza (Sektori Marikaj)*” Bashkia Vorë, në vlerën **331,610 lekë** ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “**H..I**”.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

2. “G...&K...”, e licencuar (licenca me nr. MK 0447/4, e vlefshme deri më datë 07.12.2020), me të cilën është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 145/4, datë 02.10.2012, për shkak se:

a- Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit si dhe nuk janë pasqyruar në librin e masave me referencë projektin e zbatimit.

b- Si rezultat i situacionimit më tepër volume punimesh në dy zëra punimesh të pa kryera, në objektin “*Stacioni i pompave të Ujësjellësit Vorë-Gjokaj-Picar-Dedëj dhe STP Qendror i Ujësjellësit Rajonal*” Bashkia Vorë, në vlerën **616,420 lekë** ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “**S...A dhe G...C...**”.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

3.”Z...-06”, e licencuar (licenca me nr. MK 1208/4, datë 15.02.2010), me të cilën është lidhur kontrata e shërbimit me, datë 18.01.2013, për shkak se:

a- Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të zbatimit si dhe nuk janë pasqyruar në librin e masave me referencë projektin e zbatimit.

b- Si rezultat i situacionimit më tepër volume punimesh në katër zëra punimesh të pa kryera, në objektin “*Stacioni i pompave të Ujësjellësit Vorë-Gjokaj-Picar-Dedëj dhe STP Qendror i Ujësjellësit Rajonal*” Bashkia Vorë, në vlerën **574,840 lekë** ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik “**B..I**”. (Trajtuar më hollësisht në procesverbalin nr. 7 datë 24.11.2014.)

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

Nga Bashkia Vorë, me shkresë nr. 106, prot, datë 16.01.2015, protokolluar në KLSH me nr.951/9 datë 20.01.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin

e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Halil Isufi, Shefki Jaupi, Selman Hysaj, Gerti Bode dhe Xhemal Luka më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT